



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:263547

Datë: 23.02.2021

Numri i dokumentit: 01530871

P.nr.1039/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas Gjyqtarit Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku në lëndën penale ndaj të pandehurit B. G. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 320, të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë–PP/II.nr.2513/19, të dt. 07.11.2019, gjykata mbajti seancat publike të shqyrtimit gjyqësor me dt 10.11.2020, 21.12.2020, dhe 25.01.2021, në prani të Prokurorit të Shtetit Lumturije Hoxha, përfaqësuesit të autorizuar të pales së dëmtuar-Kompanisë-së-Ardiana Kurmehaj dhe të pandehurit B. G., me datë 25.01.2021 merr dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë.23.02.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

B. G., i lindur me dt. në me vendbanim në Rr “.....” nr. 34, i biri i N. dhe nenes E. e gjinisë B., identifikohet në bazë të lnj.nr. personal, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i dy femijëve, me profesion gastronom, i gjendjes së mesme ekonomike me nr. tel., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

Në kuptim të nenit 364 par. 1 nën par. 1.3 të KPRK-së,

LIROHEN NGA AKTAKUZA

Gjëja se:

Prej dates në kohë të pacaktuar e gjerë me dt, 23.03.2018, ne, ne rr.”.....”, pikerisht ne lokalit të tij, me qëllim që vetit të sjellë pasuri të kunderligjshme, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike në dëm të kompanisë-ne atë mënyrë që zyrtaret e-it, gjatë kontrollit tek i pandehuri, është hasur në njëhisor të pa pllombë distributive, dhe kur kishin hapur kapakun për kontrollë, kanë vërejtur se i njëjti kishte bërë hyrje-daljet, e fazave

L1 dhe L2, ne një vend, qe don te thotë se energjia elektrike ne këto dy faza nuk është matur, ashtu qe në mënyrë te paautorizuar ka shpenzuar energjinë elektrike me aparatat e cekura si në procesverbalin me nr. 2179476, ku i pandehuri ka dëmtuar kompaninë e lartëcekur ne vlerë prej 3.886,44 euro.

-Me çka kishte për të kryer veprën penale “vjedhja e sherbimeve komunale” nga neni 320 të KPRK-së

Për shkak se nuk është provuar se i pandehuri ka kryer vepren penale për të cilen akuzohet.

E dëmtuara kompania-së distrikti në, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.2513/19 të dt. 07.11.2019, ndaj të pandehurit B. G. për shkak të veprës penale vjedhja e sherbimeve komunale nga neni 320 te KPRK-së,

Gjykata ka mbajtur seancat publike te shqyrtimit gjyqësor me date 10.11.2020, 21.12.2020, dhe 25.01.2021, në prani te Prokurorit të Shteti Lumturije Hoxha, përfaqesuesit te autorizuar te pales së dëmtuar-Kompanisë-së-Ardiana Kurmehaj dhe te pandehurit B. G..

Pas leximit te aktakuzës në shqyrtimin gjyqësor, të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri B. G.nuk e ka pranuar fajësinë për vepren penale për te cilen akuzohet, andaj gjykata ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor ku janë degjuar deshmitaret A. L., S. R. dhe K. G. , janë administruar provat materiale si, procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike ne terren i dt. 23.03.2018 me nr. 0724255, procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike ne terren me nr, 2179476 i dt.23.03.2018, pro faktura mbi dëmin e shkaktuar me nr.ref 724255/2179476/T16BI, fletë transaksioni i konsumatorit nga dt. 02.03.2017 e deri me dt. 20.08.2020 në emer te B. G., janë shikuar fotografrit nga vendi i ngjarjes dhe shkresat tjera të lëndes, si dhe i pandehuri B. G.ka dhënë mbrojtjen e tij.

Dëshmitari A. L. ne seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se zyrat i kanë në Prishtinë ndërsa në rastin konkret janë ftuar nga zyrat e-it në Pejë, pasi qe afër lokalitetit ku është konsumatori, ka humbje të energjisë. Me dt. 23.03.2018 ka qenë në pozitën e ekspertit për kontrollimin e energjisë elektrike, njehsorëve. Ditën për te cilën po flitet ka qenë me dy kolegët tjerë, S. R. dhe A. B.. Sa i kujtohet atë ditë kanë kontrolluar një objekt banesor i cili posedon më shumë se 20 njehsor, njehsori ka qenë i instaluar në hyrje të banesës në një panel ku ka edhe njehsor të tjerë. Zakonisht kur bëjnë shiqimin e njehsorëve, apo kontrollimin, është e arsyeshme që të jetë edhe pronari, mirëpo në rastin konkret lokalit ka qenë i mbyllur dhe nuk kanë pas qasje brenda në lokal, dhe këtë e kanë përshkruar edhe në proces., fillimisht

kanë vërejtur se njehsori ka qenë pa bllobë distributive, pas hapjes së kapakut të njehsorit kanë vërejtur se në fazën L1 dhe L2 janë përçueset hyrje dalje në një pikë. Që do të thotë se energjia e shpenzuar në ato fazë nuk është faturuar. Në pyetje e të pandehurit se “meqenëse unë numrin e telefonit e kam në, a keni provuar ju që të më kontaktoni në numrin e telefonit që e kam” dëshmitari është përgjigjur “nuk e kemi praktikë që ti ftojme pronarët e orëve me rastin e kontrollës, pasi që kontrolla është spontane” po ashtu ka deklaruar se Çelsat e ormonit ku janë te vendosura orët mundet ti ketë edhe dikush tjetër. Nuk i kujtohet se dyert e ormonit a kanë qenë te hapura apo te mbyllura. Nëse bllobat janë te këputura, inkasanti i-it që vjen çdo muaj për ta faturuar rrymën ka mundur ti vërejë shumë lehtë dhe është dashtë ti raportojë në një pajisje të cilën e posedojnë në terren dhe që tregon se bllobat mungojnë. Ndërsa në rastinin konkret nuk e din se a i ka lajmëruar inkasanti se mungojnë bllobat, është çështje e inkasantit se a dëshiron ta raportojë dëmtimin e bllobave, mirëpo e ka për obligim se çdo parregullsi ta vërejë ta lajmërojë. Në vend të ngjarjes nuk kanë bërë përpjekje për te siguruar dëshmitarë. Meqenëse lokali ka qenë i mbyllur, nuk i kujtohet ku e kanë lënë procesverbalin.

Dëshmitari S. R. ne sencen e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar, se me dt. 23.03.2018, kanë qenë në rastin e cekur në procesverbal, pasi qe ju kanë thënë që të shkojmë në atë lokalitet për shkak se janë paraqitur humbje. Kur janë shku kanë hyrë në hyrje të banesës, ku edhe kanë hasur në këtë njehsor ku ka qenë i pabllobuar, dhe kanë qenë dy lidhje të kyçura direkt, ndërsa e treta ka qenë e rregullt. Blloba distributive shihet me sy të lirë se është e këputur, apo nuk ka qenë fare blloba. Gjatë kontrolles kanë qenë prezent vetëm këta tre punëtorët e-it të cilët kanë ardhur nga Prishtina. Sa i kujtohet një lokal afër ka qenë shisha bar dhe ju kanë thënë se nuk punon rregullisht ky lokal. Pasi që e kanë përpilu procesverbalin nuk i kujtohet saktësisht se çfarë kanë bërë, mirëpo e dinë se e kanë lajmëruar koordinatorin e Pejës, për verifikimin e pajisjeve pasi që të hapet lokali. Dyert e ormanit ku janë të vendosura të gjitha orët në hyrje të banesës kanë qenë të mbyllura, mirëpo këta i kanë çelësat universal që mund ti hapim shumicën e ormanëve. Çelësat mund ti ketë përgjegjësi i objektit, apo mirëmbajtësi. Në bazë të numrit të njehsorit, e kanë ditur se në emër të kujt është njehsori, mirëpo nuk i kujtohet nëse kanë bërë përpjekje për te kontaktuar te pandehurin.

Dëshmitari K. G. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se data nuk i kujtohet, mirëpo rasti i kujtohet pasi qe kanë marr një kërkesë nga zyra për me shku me bo regjistrimin e pajisjeve në vendin e cekur. Kanë shku në lokal, kanë kontaktuar një punëtor dhe e kanë njoftuar se kanë me bo regjistrimin e pajisjeve. I kanë regjistruar pajisjet çka kanë gjet aty. Nuk e dinë sa ora ka qenë kur kanë shku me bo regjistrimin e pajisjeve dhe nuk kujtohet se në çfarë kohe ka qenë a ka qenë paradite a mbasdite, aty ka qenë një punëtor i lokalit , kur e kanë bërë regjistrimin e pajisjeve në lokal .

I pandehuri B. G. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se dyshon se e gjithë kjo është një montim nga personat që nuk ja dëshirojnë të mirën, pasi që në atë orë nuk ka pas qasje dhe se dëshirojnë ta dëmtojnë financiarisht. Ka shtuar se, edhe më herët ka pas probleme të tilla, kur ju ka djeg lokali në vitin 2013, në vitin 2015 ju ka djegur makina dhe tash kur e ka hap lokalin tjetër të ri, i ndodhi problemi me orë. Andaj dyshon se të njëjtit persona që ja kanë djegur lokali, veturën, kanë mundur të ja bëjnë edhe këtë dhe kanë mundur të ja prekin edhe orën elektrike, pasi që ora ka qenë në pronë publike. Kanë mundur të ja bëjnë edhe ndonjë dëm tjetër, mirëpo tani çdo pronë e ka siguruar KASKO, ndërsa lokalin e mban me roje. Lokalin për të cilën bëhet fjalë, sa i kujtohet e ka mbajtur nga Shkurt i vitit 2017, deri në Mars të vitit 2018. Zyrtarët e kanë qenë çdo muaj në vizitë për ta marr gjendjen e orës dhe asnjëherë nuk ka pas problem me I pandehuri mendon se qëllimi i këtij rasti ka qenë vetëm ta dëmtojnë, sepse kontrolla ka ardhur direkt në lokal tek aj. Ne lokal në fillim ka punuar çdo ditë verës, kurse dimrit kanë punuar vetëm njëherë në javë, ku edhe nxemja nuk është dhez, pasi

që kanë punuar me muzikë live dhe personat kanë ndejt në këmbë dhe nxemja nuk ka qenë e ndezur meqenëse nuk ka pasur nevojë, sepse ka pasur shumë njerëz. I pandehuri ka shtuar se edhe tani kur këtë lokal e mbajnë personat tjerë dhe aty është duke u punuar çdo ditë, mund ta shihni te transkripti i konsumatorit se faturat vijnë ndër vlerën 200 euro, edhe pse është dimër.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale në tërësi u vërtetua se i pandehuri B. G. është kryes i kësaj veprë penale për të cilën pandehet. Gjatë shqyrtimit gjyqësor patëm rastin të dëgjojmë dëshmitarët të cilët deklaruan se ditën kritike gjatë inspektimit nga ana e zyrtarëve, kanë hasur në njehsorin e këtu të pandehurit i cili ka qenë i pa bllobuar si dhe në të kanë qenë dy lidhje të kyçura direkt, ndërsa lidhja e tretë ka qenë e rregullt. Andaj nga të lartcekurat gjykatës i propozon që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënojë sipas ligjit dhe ta obligojë në paguarjen e shpenzimeve procedurale

Përf. i aut. i të dëmtuarës-në fjalë përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën e prokurores së shtetit sa i përket kërkesës pasurore juridike kërkon që të aprovohet dhe i pandehuri të ju paguajë dëmin e shkaktuar.

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaroi se e ndien vetën plotësisht të pafajshëm, nuk e di si ka ndodh kontrolli, nuk ka qenë i informuar as kur është kryer kontrolli dhe nga një logjikë e thjeshtë dihet se nuk mund ta dëmtosh bllobën, sepse e njëjta shihet sa herë që-i vjen në kontrolle për ta faturuar dhe dyshon se e gjithë kjo është një montazh.

Gjendja faktike e vërtetuar nga ana e gjykatës

Me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata vlersoi se nuk është provuar se i pandehuri B. G. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Pas administrimit të provave gjykata gjeti se ditën kritike me dt. 23.03.2018, A. L., S. R. dhe A. B., në cilesi të puntoreve të kompanis-së kanë shkuar në vendin e e cekur në dispozitiv të ketij aktgjykimi dhe gjatë kontrollit të njehsorve elektrik, kanë hasur në njehsor të pa pllombuar dhe kur kanë hapur kapakun për kontrollë, kanë gjetur se dy fazat L1 dhe L2, janë të lidhura në atë mënyrë që në këto dy faza nuk është matur energjia e shpenzuar.

Gjyakta gjeti se sipas dispozitivit të aktakuzes, i pandehuri akuzohet se veprën penale e ka kryer në lokalit të tij, ndërsa pas administrimit të provave dhe degjimit të dëshmitareve, gjykata gjen se vendi ku janë të vendosura njehsorët elektrik është vend i përbashkët ku janë të vendosur të gjithë njesoret e asaj banese dhe të gjithë banorët e banesës kanë qasje në to. Sipas dëshmitareve të degjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, njehsori i të pandehurit është i vendosur në hyrje të banesës së bashku me njehsorët tjerë të banorëve të asaj banesë kolektive.

Në këtë rast nuk ishte kontestues fakti se njehsori i energjisë elektrike, në kompanin ishte i regjistruar në emër të pandehurit B. G., mirëpo gjykata vlersoi se vetëm fakti se një person e ka njehsorin e energjisë elektrike në emër të tij, nuk e bën atë automatikisht kryes të veprës penale, nese në një kohë të caktuar në atë njehsor verëhet ndonjë parregullsi, për deri sa nuk kemi prova se personi konkret ka ndërruar ndonjë veprim të caktuar për të shkaktuar atë parregullsi.

Duke pas parasysh edhe deklaratën e dëshmitarit S. R. që është edhe puntor i-it i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se “Kur janë shkuar në hyrje të banesës, ku edhe kanë hasur në këtë njehsor ku ka qenë i pa bllobuar” po ashtu ka deklaruar se “Blloba distributive shihet me sy të lirë se është e këputur, apo nuk ka qenë fare blloba” ndërsa

dëshmitari Arian Luta ka deklaruar se “Nëse bllobat janë të këputura, inkasanti i-it që vjen çdo muaj për ta faturuar rrymën ka mundur të vërejë shumë lehtë dhe është dashtë të raportojë në një pajisje të cilën e posedojnë në terren dhe që tregon se bllobat mungojnë”, andaj ky fakt për gjykatën len të kuptohet, se i pandehuri Bardh nuk e ka kryer këtë veprë penale, pasi që fakti se blloba mungon, është fakt që do të vërtetohet menjëherë posa inkasanti i rrymës shkon për ta marr gjendjen e njehsorit, andaj edhe i pandehuri nuk do ta kryente një veprim të tillë duke e ditur se i njëjti do të vërehet menjëherë po sa të vije inkasanti i kompanisë

Gjykata ju fali besimin deklaratave të dëshmitareve S. R. dhe Arian Luta të cilët deklaruan se gjatë kontrollës e kanë hasur njëisorin e pabllombuar dhe dy lidhje L1 dhe L2, nuk kanë regjistruar energjinë e shpenzuar, mirëpo vetëm këto rrethana për gjykatën nuk ishin të mjaftueshme që të vërtetonte faktin se i pandehuri Bardh është kryes i veprës penale. Kjo për faktin se njehsori i energjisë ka qenë i vendosur në vend të përbashket, ku janë të vendosur edhe njehsoret tjerë në hyrje të banesës, ku në këtë vend, kanë qasje të gjithë banoret tjerë dhe jo vetëm i pandehuri. Po ashtu fakti se dëshmitaret deklaruan, se me sy të lirë vërehet se blloba e njehsorit elektirik ka munguar, prandaj duke ditur faktin se puntoret e kompanisë-së, shkojnë çdo muaj, përkatesisht inkasanti çdo muaj merr gjendjen e njehsorit, atëherë i pandehuri në këtë rast do ta kishte ditur se inkasanti i, me sy të lirë do ta verente mungesën e bllobes së njehsorit dhe do ta raportonte rastin, siç deklaroi edhe dëshmitari A. L. , i cili deklaroi se “Nëse bllobat janë të këputura, inkasanti i-it që vjen çdo muaj për ta faturuar rrymën ka mundur të vërejë shumë lehtë dhe është dashtë të raportojë në një pajisje të cilën e posedojnë në terren dhe që tregon se bllobat mungojnë”.

Ndërsa fakti se i pandehuri në këtë rast mund të ketë përfitim nga keqperdorimi i energjisë elektrike nuk është provë që vërteton veprën penale, pasi që faktin se në këtë njehsor mungonte blloba ka mundur të shifet me sy të lirë nga inkasanti i energjisë elektrike andaj edhe përfitimi nga keqperdorimi i energjisë elektrike do të hetohet me rastin e vizitës së parë nga inkasanti. Ndërsa sa i përket faktit se faza L1 dhe L2, nuk kanë regjistruar energjinë e shpenzuar gjykatë nuk pati ndonjë provë se këtu i pandehuri ka nderhyrë në ato faza dhe nuk pati ndonjë provë se i pandehuri ka njohuri profesionale që të nderhy në njehsorin e energjisë elektrike me qëllim të manipulimit me të.

Nga fletë transaksioni i konsumatorit në emër të pandehurit nuk vërehet se i pandehuri, ka pasur ndonjë ndryshim të konsiderueshëm nga muaji në muaj, duke pas parasysh edhe faktin se në kohën kur dyshohet se ka ndodhur vepra penale, lokali nuk ka qenë duke punuar vazhdimisht por vetëm në fundjavë. E po ashtu, me rastin e kontrollës nga ana e puntoreve të-it lokali në fjalë ka qenë i mbyllur.

Dëshminë e dëshmitarit K. G. , nuk e kontestoi asnjëra palë, pasi që ky dëshmitar deklaroi vetëm faktin se si i kanë regjistruar paisjet elektrike që gjendeshin në lokal.

Po ashtu fakt tjetër që gjykata mori parasysh me rastin e lirimit nga aktakuza të pandehurit ishte fakti se puntoret e-it, deklarun se, pasiqe kanë hasur në njehsor të pabllombuar nuk kanë bërë asnjë përpjekje të kontaktimit të pronarit të ores, e po ashtu nuk kanë bërë asnjë përpjekje për sigurimin e ndonjë dëshmitari tjetër përveç puntoreve të-it.

Gjykata e vlerësoi edhe deklaratën e të pandehurit i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se nuk ka pas qasje në atë njehsor dhe dyshon se e gjithë kjo është një montim nga personat që nuk ja dëshirojnë të mirën, dhe dëshirojnë ta dëmtojnë financiarisht, ku e ceku edhe rastin kur ja kanë djegur lokalin në vitin 2013, dhe në vitin 2015 ja kanë djegur makinën, mirëpo gjykata

edhe pse nuk vërtetoi faktin se e gjithë kjo ka mund të jetë montim për të dëmtuar te pandehurin , po ashtu nuk vërtetoi faktin se i pandehuri ka kryer këtë veprë penale.

Sipas nenit 8 të KPRK-së “vepra penale mund të kryehet me veprime ose me mos veprim” ne këtë rast, gjatë shqyrtimit gjyqesor me asnjë provë nuk u vertetu se i pandehuri ka ndërmarr ndonjë veprim për kryerjen e kesaj vepre penale. E po ashtu i pandehuri këtë veper nuk e ka kryer edhe nga mos veprimi i tij, pasi qe nuk ka pasur ndonjë obligim ligjor te veprojë në mënyrë te caktuar, përkatesisht nuk ka qënë përgjegjes për ruajtjen e njehsorit elektrik, i cili është vendosur në hapsirë te përbashket me njehsoret tjerë dhe ku te gjithë banoret e objektit banesor e po ashtu edhe punëtorët e-it kanë qasje te pa kufizuar, prandaj gjykata gjatë shqyrtimit gjyqesor nga provat e admionistruara nuk vërtetoi asnjë fakt se i pandehuri ka marrë ndonjë veprim ne drejtim te kryerjes së vepres penale.

Përsëri duhet të theksohet së në vendin ku janë të vendosur njehsorët elektrik kanë qasje të gjithë banorët, është vendi i përbashket në hyrje te baneses, njehsori elektrik nuk ka qenë i vendosur ne një vend privat ku i pandehuri ka mundur ta ketë mbikqyrjen e drejperdrejtë, andaj për derisa nuk dihet kryesi i veprës penale, gjykata nuk mund ta shpall fajtor pronarin apo shfrytëzuesin e njehsorit vetëm me arsyetim se është pronar dhe shfrytëzues i njesorit.

Andaj, nga te lartcekurat gjykata gjen se nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale me te cilën akuzohet, andaj edhe është liruar nga aktakuza.

Konform nenit 463 par. 3 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën e udhëzoi në kontest civil.

Konform nenit 454 par 1 të KPRK-së, shpenzimet e procedures penale bijen barrë e mjeteve buxhetore te kesaj gjykate.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 par 1 nenpar 1.3 të KPP-së gjykata vendosi si në dispozitiv te këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.1039/19 më datë 23.02.2021

Sekretarja Juridike
Fitore Bojku

GJYQTARI
Shaqë Curri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës
së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.